**V E N D I M**
**Nr. 254, datë 13.6.2002**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.62, DATË 7.3.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË VILËS 30".**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 14 dhe 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.62, datë 7.3.2002 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të vilës 30", të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisionit të Shërbimit Civil t'u jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, vila 30, me të gjithë territorin përreth. Instituti dhe Komisioni nuk kanë të drejtë t'ua japin mjediset e kësaj vile në përdorim, pa shpërblim apo me qira, të tretëve.".

2. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Ngarkohen Instituti i Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisioni i Shërbimit Civil të përballojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në përdorim.".

3. Pas pikës 3 të shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Ngarkohet Instituti i Trajnimit të Administratës Publike të vërë në dispozicion të Komisionit të Shërbimit Civil pjesën e mjediseve, sipas skemës që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

860
335
510
WC
ING. TRAJKOVIĆ
KONSTAN. NEP. OVA


NR. 30
WC
WC
WC
WC
WC
WC
150
360
620
560
380
110
130
853
518
830
540
520
270
490
350
1140
545
226


PLANI I NEN
4.0
2.2
1.2
5.4
5.8
3.0
2.0
WC
4.0
2.2
2.8
3.6
VILA 30